



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____._____2026

PROCES VERBAL

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V NDRICUES FOTOVOLTAIKË per nevoja te Bashkise Vlore – Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik -ku te gjitha kushtet jane te percaktuara -me afat (12 muaj) .

• KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT
34993000-4 - Ndriçues rrugorë, 09331000-8 - Panele diellore,

Fondi limit : 49,691,500 (Dyzete e nentemilion e gjashtëqind e nentdhjetë e njemije e pesëqind) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 515,418 (Pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) Euro pa TVSH

Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021 ne vleren : Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vlore** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës*, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore përgjate tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

2. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të*

vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së

parashikuar të kontratës; ne piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:* a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;; Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontraten sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:* a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi bazuar ne vleren e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

- 2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, të paraqitura pranë organeve perkatese tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme, nuk ka

raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”,

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kasti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.3. Për kapacitetin teknik: Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shenohen, vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do të vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi:Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin parashikohet se:

3. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.1 Ofertuesi duhet te paraqese katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve per zerat e mallrave sipas tabelës se meposhtme,me te dhenat teknike, ku të

jene te percaktuar zerat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre. Ne katalog/katalogje duhet te markohet produkti qe ofrohet.

Emertimet e mallrave ne tabelen e meposhtme per te cilat duhet te paraqiten katalogë, i perkasin **zerit 2**, te preventivit te Shtojces nr.7 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit" ne DST

Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten katalogë:

Nr.	Emertimi i mallrave
2.	Ndriçues Solar me bateri dhe komandë për fluksin e ndriçimit dhe rele muzgu. Ndriçimi: 100–120Ë LED, 11,000–13,200 LM. Panel Solar: 45W Polikristaline. Bateri: Litium 50Ah LiFePO4

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet katalogje per disa mallra objekt prokurimi sipas tabelës per shkak te peshës specifike qe zene ne preventivin e mallrave. Paraqitja e katalogjeve per disa zera mallrash, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per zerat e mallrave sipas tabelës se meposhtme. Ne rast se do te paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave si dhe origjinale ose fotokopje e noterizuar.

Emertimet e mallrave ne tabelen e meposhtme per te cilat duhet te paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori, i perkasin **zerit 2** te preventivit te Shtojces nr.7 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit" ne DST

Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:

Nr.	Emertimi i mallrave
2.	Ndriçues Solar me bateri dhe komandë për fluksin e ndriçimit dhe rele muzgu. Ndriçimi: 100–120Ë LED, 11,000–13,200 LM. Panel Solar: 45W Polikristaline. Bateri: Litium 50Ah LiFePO4

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar; pika 6b dhe pika 8, e nenit 40, të VKM-së

Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar ku është e cituar: *8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”, si dhe duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-se dhe rekomandimeve të APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori për mallra objekt prokurimi.

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standarteve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 3 vjecare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet kete dhe të paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si mëposhte:

a. Certifikate: EN –ISO 9001:2015-Sistemi i Menaxhimit të cilesisë;

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt- marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përmbushja e standarteve ISO është thelbësore, dhe i siguron AK se operatori ekonomik fitues është serioz dhe ka kaluar procese vlerësimi në lidhje me respektimin e standarteve të mësipërme të cilat kanë lidhje me objektin e prokurimit.

Konkretisht:

Certifikate: EN- ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë - Përmbushja e standardit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Nisur nga proceset e punes dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punes së tij, t'i bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë e kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i punë të krijuar për hartimin e e projektit ,preventivit, afatit të punimeve dhe relacionin teknik , në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E

